

Tryezë e rumbullakët virtuale

Takimi i 9-të i Grupit Kombëtar të Punës për RAP, Shqipëri

Angazhimi qytetar në Reformën në Administratën Publike: rezultatet e monitorimit 2021/2022 dhe përvojat nga monitorimi i qeverisjes vendore

20 qershor 2023, online në Zoom, ora 10:00 – 11:35

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ju fton në tryezën e rumbullakët për angazhimin qytetar në reformën në administratën publike (RAP). Tryeza ka dy seanca të veçanta për RAP në nivelin qendror dhe RAP në nivelin vendor.

Në seancën e parë të tryezës prezantohen gjetjet e ciklit të tretë të Monitorimit të RAP 2021-2022, për Shqipërinë. Raporti përmban të dhëna të krahasueshme ndër vite mes cikleve 2017/2018 dhe 2019/2020, parë nga këndvështrimi i shoqërisë civile. Të dhënat mundësojnë të vërehet përparimi dhe regresi i zbatimit të RAP në fushat e monitoruara, me rezultate të krahasuara për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Prezantimi i gjetjeve të raportit do të pasohet me diskutimin mes përfaqësuesve të institucioneve publike zbatuese të RAP-së në vend, organizatave të shoqërisë civile anëtare të Grupit Kombëtar të Punës për RAP në Shqipëri dhe të interesuarve të tjerë.

Seanca e dytë e tryezës i kushtohet rolit të angazhimit qytetar në RAP në nivelin vendor. Gjashtë organizata të shoqërisë civile do të prezantojnë punën monitoruese të projekteve të tyre që u zbatuan përmes instrumentit të granteve të vogla "Shoqëria civile vendore në RAP", gjatë viteve 2021 – 2022. OSHC-të kanë monitoruar disa aspekte të RAP në nivelin e qeverisjes vendore si transparenca, llogaridhënia, konsultimi publik, buxhetimi me pjesëmarrje, etj. në shumë bashki të vendit.

Tryeza e rumbullakët zhvillohet virtualisht në platformën Zoom, më 20 qershor 2023, e martë, ora 10:00 – 11:35. Gjuha e takimit është shqipja, me përkthim simultan në gjuhën angleze. Për të marrë pjesë në takim, luteni të regjistroheni duke klikuar [në lidhjen e Zoomit](#).

Tryeza e rumbullakët organizohet në kuadër të projektit rajonal WeBER 2.0 "Fuqizimi i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor për një Administratë Publike të Reformuar" që zbatohet nga rrjeti TEN dhe financohet nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë.

par-monitor.org

DRAFT AGJENDA

20 qershor 2023, platforma Zoom

10:00 – 10:50	Gjetjet e ciklit të monitorimit RAP 2021/2022
10:00 – 10:05	Fjala hapëse Rëndësia e monitorimit të zbatimit të reformës në administratën publike <ul style="list-style-type: none">▪ Rovena Sulstarova, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
10:05 – 10:30	Prezantimi i gjetjeve të monitorimit të Reformës në Administratën Publike 2021/2022 <ul style="list-style-type: none">▪ Alban Dafa, Hulumtues
10:30 – 10:50	Diskutim i hapur
10:50 – 11:35	Si ndikon angazhimi qytetar në RAP në nivelin vendor: përvoja e shoqërisë civile me instrumentin e granteve të vogla 2021-2022
10:50 – 11:20	Roli i shoqërisë civile në monitorimin e RAP në nivelin vendor: Përvojat e terrenit nga gjashtë organizata vendore <ul style="list-style-type: none">▪ Elma Tërshana, Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve▪ Iris Shima, Instituti Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I)▪ Ndriçim Çela, Shoqata AlbNatyra▪ Mimoza Hajdarmataj, Gratë në Shërbim Publik (WPS Albania)▪ Qendra e Zhvillimit dhe Demokratizimit të Institucioneve (e pakonfirmuar)▪ Ardmir Doda, Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë (QSNNN) Moderon: <ul style="list-style-type: none">▪ Adela Kula, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim
11:20 – 11:30	Diskutim i hapur
11:30 – 11:35	Mbyllja e diskutimit